



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJËSI TË
KUFIZUAR “ILLYRIAN VIRTUAL ASSISTANCE” SHPK**

AKT THEMELIMI DHE STATUT “ILLYRIAN VIRTUAL ASSISTANCE” SHPK

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më **11 nëntor 2022**, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ILLYRIAN VIRTUAL ASSISTANCE” SH.P.K.
- 1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:
 - **Znj. Visara Selimi**, shtetas shqiptar, e lindur në Shkodër, më 11.07.1996, mbajtese e kartes se identitetit nr. 038348961 dhe numër personal **J65711086V**.
 - **Z. Ersid Saloviq**, shtetas shqiptar, i lindur në Shkodër, më 3.08.2000, mbajtese e kartes se identitetit nr. 033252012 dhe numër personal **K00803116S**.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Zona Kadastrale nr.1244, Boriç i Madh nr. 523/1, Vrake, Malësi e Madhe, Shqipëri.
- 2.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: illyrianva@gmail.com
- 2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

Neni 4

Objekti

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - (a) Shoqëria ofron një platformë që cakton asistentë virtualë për klientët.
 - (b) Shoqëria ofron konsulencë dhe ndihmë virtuale për klientët që duan të kontraktajnë:
 - 1) Detyra administrative dhe menaxheriale:**

Shoqëria do të përfshijë ofrimin e asistencës dhe konsulencës klientëve në detyrat e tyre administrative, të tilla si, por jo vetëm: strategjia e biznesit dhe teknikat operacionale, mbështetja e klientit përmes emaileve dhe telefonatave, menaxhimi i kalendarëve, përgatitja e raporteve, analiza, financa, auditime, dhe të gjitha aktivitetet e ndërlidhura.

2) Konsulencë dhe assistencë për teknologjinë:

Shoqëria do të përfshijë ndihmën e klientëve në hartimin/mirëmbajtjen e uebit, kodimin e faqes në internet, konvertimin e skedarëve dhe të gjitha aktivitetet e lidhura me to.

3) Konsulencë dhe assistencë për sigurinë (fizike dhe kibernetike):

Shoqëria do të shërbejë si një qendër ekspertize për sigurinë (fizike dhe kibernetike). Assistenca e sigurisë do të fokusohet në konsulencën e klientëve në lidhje me dobësitë e sigurisë të kompanisë dhe do të bëjë rekomandime për të përmirësuar sigurinë e kompanisë fizike dhe kibernetike, edhe të gjitha aktivitetet e lidhura me to.

4) Konsulencë dhe assistencë në lidhje me ndërtimin e një strategjie të qëndrueshmërisë në biznese.

- 4.2 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.
- 4.3. Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë qdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose të huaj. Shoqëria mund të ushtrojë çfaredolloj aktiviteti tjetër të papercaktuar në këtë akt, të çfaredolloj natyre që nuk është në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi pa asnjë kufizim.

KREU II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqindmije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues Znj. **Visara SELIMI** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben **85%**, 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) Lekë, të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. Ortaku themelues Z. **Ersid SALOVIQ** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben **15%**, 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Lekë, të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.
- 6.2 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 11 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

11.2 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një person fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

- 13.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.3 Personi e mëposhtëm caktohet si Administratori i parë të Shoqërisë:

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

Z. **Ersid Saloviq**, shtetas shqiptar,
i lindur në Shkodër, më 3.08.2000,
ID nr. 033252012 dhe numër personal **K00803116S**;
adresa: Boriç i madh nr. 22, Vrake, Malësi e Madhe.



Neni 14 **Kompetencat e Administratorit**

- 14.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asambletë të Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 **Përgjegjësitë e Administratorit**

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

- 15.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

- 17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 18

Dividendi

- 18.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 18.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyre proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 19

Prishja dhe likuidimi

- 19.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- 19.2 Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.
- 19.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 19.4. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 20.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 21

Baza Ligjore

- 21.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

Mosmarrëveshjet


- 22.1 Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tremeve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ILLYRIAN VIRTUAL ASSISTANCE



Visara Selimi



Ersel Saloviq